

Date 15/02/2025

STATUTI
I
SHOQERISE "KORÇA IMPORT-EXPORT" SHPK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 1

Unë themeluesi i shoqërisë "**KORÇA IMPORT-EXPORT**" SHPK me gjeneralitetet e cituara me poshtë :

1-Gianfranco Paderno : i biri i Basilio, lindur ne Brescia, Itali me daten 19.01.1962 dhe banues ne Korce ne adresen : Rruga " Gaqo Qeleshi", mbajtes i leternjoftimit (leje qendrimi) me nr. G23119004G.

2-Alfred dal Bianco : i biri i Cesare, lindur ne Adliswil, Zvicër me daten 25.03.1965 dhe banues Itali, mbajtes i leternjoftimit te huaj me nr. DLBLRD65C25Z133L.

3-Denis Lika : i biri i Arbenit, lindur ne Korce, me daten 01.03.1990 dhe banues Korce, mbajtes i leternjoftimit te huaj me nr. J00301112G

deklarojme se aktiviteti i shoqërisë "**KORÇA IMPORT-EXPORT**" SHPK, do te organizohet dhe zhvillohet ne baze te ketij statuti dhe kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqërite tregtare".

Neni 2

Shoqëria "**KORÇA IMPORT-EXPORT**" SHPK është person juridik shqiptar dhe si i tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar, sipas ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është fiksuar për një periudhe kohe te pakufizuar.


Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka si objekt te veprimtarisë se saj:

A- Sipermarrjen ne fushen e tregëtimit si brenda dhe jashte vendit (import-export) te produkteve ushqimore te mishit dhe nenprodukteve te tij , bulmetit dhe nenprodukteve te tij, vererave dhe pijeve alkoolike etj.

Neni 5



Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtte ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në leke apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 **SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë dhe Zyrat Qendrore të saj janë në adresën **Lagja 6 Rruga "Gaqo Qeleshi"** Objekti me Nr 19 Asambleja ka kompetencën të hapë filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllë ato, nëse e quan të nevojshme.

KREU II **KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA** **Neni 7**


Kapitali themeltar i shoqërisë perbehet vetem nga kontribute në para dhe është 120.000 leke (Njëqind e njëzet mijë) Leke. Ai është i ndarë në 3 (tre) kuota të cilat zotërohet në mënyrë të barabartë nga ortakët themelues si më poshtë :

1. **Gianfranco Paderno** zotëron 1(një) kuota të barazvlefshme me 33.33 **(tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre)%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Alfred dal Bianco** zotëron 1(një) kuota të barazvlefshme me 33.33 **(tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre)%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. **Denis Lika** zotëron 1(një) kuota të barazvlefshme me 33.33 **(tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre)%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, kanë të drejtë të kryejnë pagesa apo të japin kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqërisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financiar, afati i kthimit dhe mënyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën perkatese. Shumat e mesiperme mund të perdoren për të mbuluar humbjet ose transferohen direkt në rritjen e kapitalit në përputhje me vendimin e asamblese se ortakeve.

KREU III **TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TE KAPITALIT THEMELTAR** **Neni 8**

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme, ndërmjet ortakeve (me kontratë shitblerje ose dhurimi), ndërmjet bashkëshorteve (në rastin e ndarjes së pasurisë në bashkëpronësi familjare) dhe tek trashëgimtarët (në rast vdekje), dhe kalimi i tyre bëhet pa miratimin e asamblese, (të ortakeve të tjere).



Transferimi i pjesëve nominativë të kapitalit themeltar tek te tretet (persona fizike ose juridike jashtë bashkësisë së ortakëve) bëhet duke eazauruar fillimisht, te drejten e parablerjes së ortakëve të tjerë, në përputhje me procedurën që vijon:

Ortaku që kërkon të transferojë kuotën e tij, tek te tretet, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar që fillimisht t'i rezervojë ortakëve të tjerë të drejtën e parablerjes. Për të mundësuar ushtrimin e kësaj te drejte, ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij (ose një pjesë të saj) duhet të lajmërojë me shkrim (me letër-rekomandë) të gjithë ortakët që figurojnë në Statut (në adresën që rezulton në statut për secilin ortak), duke specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve të mundshëm.

Çdo ortak i interesuar për blerjen e kuotes, duhet ti përgjigjet ortakut ofertues, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, me të cilin deklaron se dëshiron të ushtrojë te drejtën e parablerjes për teresinë e të gjitha kuotave të ofruara (ose për një pjesë të tyre). Njoftimi duhet t'i dërgohet ortakut ofertues brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertes, në të kundërt konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta e parablerjes, dhe ortakut ofertues është i lire të transferojë kuotën tek te tretet, por jo me çmim më të ulët dhe me kushte më të favorshme se çmimi dhe kushtet që i ka ofruar ortakëve, në të kundërt shitja e kuotes tek te tretet konsiderohet e pavlefshme.

Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, pjesëmarrja në oferte e secilit ortak do të jetë në përpjestim me kuotat që zoteron secili prej tyre.

Nëse një ortak që gëzon te drejtën e parablerjes nuk mundet ose nuk dëshiron t'a ushtrojë atë, e drejta e ortakut që refuzon apo terhiqet, (e drejta e parablerjes për këtë pjesë) i kalon ortakëve të tjerë në proporcion me kuotat që zoteron secili.

E drejta e parablerjes ushtrohet për çmimin e ofruar nga ofruesi.

Perjashtohet e drejta e parablerjes për rastet e pengut, por ortakët kanë te drejtë të marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm apo të shitjes së kuotave të lena peng.

KREU IV ASAMBLEJA Neni 9

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë, që përfaqëson tërësinë e ortakëve.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Statut dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët. Ato protokollohen në regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka te drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja ka këto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/et, miraton buxhetin vjetor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- Vendors per pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendors per riorganizimin (shendrrimin, bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen), dhe/ose prishjen e shoqërisë;
- Vendors per transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkembimin) e pasurive te shoqerise, per cedimin apo per dhenien me qira te shoqerise ose degeve te saj, per dhenien me qera te asetëve te shoqerise, per marrjen me qera te objekteve apo asetëve te ndryshme, per kontratat leasing, per pjesemarrjen ne kapitalin e kompanive te tjera nepermjet pjesemarrjes ne kapital, blerjes se kuotave apo aksioneve;
- Vendors per miratimin e huamarrjeve me interes nga te tretet, si dhe per huamarrjet pa interes per vlera mbi 20.000 Euro (njetzetemije);
- Vendors per dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguruese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel te miratuar;
- Miraton shperdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes se dividendeve ose vendors per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;
- Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;
- Vendors për ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji;

Neni 10 Vendimarrja


Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 për qind të kapitalit te shoqerise (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me 75% (shtatedhjeteepesepetëqind) te votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shnderrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;


- Percaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shperblimeve për çdo pozicion pune në shoqëri, duke përfshirë edhe percaktimin e pages apo shperblimit të Administratorit, ekspertit kontabel të miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, refuzon kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, për nisjen e një hetimi të posaçëm ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve të atëherë, kërkuarist kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës.

Neni 11 Zmadhimi i kapitalit themeltar

Vendoset nga Asambleja me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës. Pas vendimit të asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet të bëjnë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që zotëron secili.

Ortakët që kanë votuar kundër zmadhimit të kapitalit nuk janë të detyruar të kontribuojnë. Depozitimi i kapitalit të zmadhuar, bëhet vetëm nga ortakët që kanë votuar pro rritjes së kapitalit, secili sipas kuotës që është vendosur në asamble. Në mungesë marrëveshje për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes së kontributeve të sipërpërmendura, Administratori/et duhet të regjistrojnë në librin e ortakëve zmadhimin e kapitalit, duke marrë nënshkrimin e atyre që kanë pranuar; si dhe të vazhdojnë me një përshkrim të ndarjes së kapitalit midis ortakëve.

Administratori/et me ligj dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'u kërkojnë llogari ortakëve që kanë nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit

Vendoset nga Asambleja me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës.

Kur vendimi i zvogëlimit të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë; ata mund të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 Transformimi

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri anonime, bëhet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave, në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozitë.

ADMINISTRIMI Neni 14

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një Administratori të Vetëm, që mund edhe të jetë ortak në shoqëri. Administratori i vetëm emërohet për një periudhë prej 5 vjetesh me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Në detyrën e Administratorit emërohet: Z. Denis Lika i biri i Arbenit, lindur në 01.03.1990, banues në Korce, mbajtes i letërnjoftimit me nr. J00301112G

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tij, ai ka të drejtë dhe detyrim të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; të përfaqësoj shoqërinë tregtare; të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; të përgatis dhe nënshkruajë bilancin jetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; të krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund të vere në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokurë në rastë gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

Neni 15

Administratori mund të emërojë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë të drejtën e firmës, si dhe ato kompetenca, shpërblime e garanci që do të vlerësojë të arsyeshme. Ai mundet gjithashtu të emërojë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të aktuar.


Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori (apo administratorët nëse do të emërohen të tilla) janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete të kryera nga administratori në kundërshtim me kompetencat e tij, kur vërtetohet se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëm nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.



Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhënë një motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratoreve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

Administratori/ret mund të heq/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori/ret, që jep dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

PERFAQESIMI I PUNEMARRËSVE

Neni 18

Nëse shoqëria ka me shume se 50 punonjës atëherë ata kane te drejtën te organizojnë një Këshill te punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me te drejte ripërtëritje ose kur shoqëria ka te punësuar me shume se 20 punëmarrës po me pak se 50 atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Neni 19

Emërimi i ekspertit kontabël te autorizuar behet me vendim te asamblesë se përgjithshme e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël te autorizuar, janë te pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Neni 20

Eksperti Kontabël i autorizuar pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton qe kontabiliteti vjetor është mbajtur ne rregull, i korrespondon te vërtetës dhe është ne përputhje me legjislacionit ne fuqi.


Mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te asamblesë se përgjithshme si dhe me vendim gjykate.

Eksperti Kontabël i autorizuar përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi lështrimin vjetor qe pasqyron situatën financiare ne nisje dhe atë ne mbyllje.

Kontrollon qe bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblesë, t'i korrespondoje realitetit.

Është i detyruar ti paraqesë Administratorit dhe asamblesë se ortakeve:

a) Kontrollat, verifikimet dhe sondazhet e bëra ;



b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sygjerruar edhe zgjidhjet;

c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara;

d) Rezultatit financiar pas korrigjimeve të bëra;

Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e asamblesë së ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund të thirret në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 21

Eksperti kontabël i autorizuar përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar asamblesë.

KREU IV FITIMIT DHE FONDET Neni 22

Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjatë vitit financiar të sapo mbyllur.

Asambleja mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

Neni 23

Asambleja vetëm pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakun e vetëm.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut të vetëm, vetëm nëse administratori apo administratori, nën përgjegjësinë të tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nën Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare".

Gjatë vitit, shoqëria ka të drejtë t'i japë ortakut të vetëm paradhënie mbi dividendët në vlera jo më të mëdha se dividendi i shpërndarë një vit më parë, me kusht që:


a) Të mbetet e depozituar një rezervë, e barabartë me paradhëniet që do të shpërndahen;

b) Një Eksperti kontabël i autorizuar të vërtetojë në një relacion me shkrim që fitimet neto të realizuara deri në atë moment janë më të mëdha se paradhëniet që parashikohen për tu shpërndarë ortakeve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga asambleja ose administratori. Në vendimin përkatës duhet të specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividendët që nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve që i kanë marrë ato.

KREU V PAVLEFSHMERIA E SHOQERISE, PRISHJA, LIKUJDIMI DHE LARGIMI I ORTAKEVE Neni 24



Pavlefshmeria absolute apo relative e themelimit të shoqërise, mund te konstatohen apo te shpallen vetem nese plotesohen nje apo disa nga kushtet e parashikuara ne nenin 3/1 te Ligjit Nr. 129/2014. Edhe pasojat e pavlefshmerise, do te zgjidhen ne perputhje me kerkesat e dispozites se cituar me siper.

Neni 25

Shoqeria mund te priset vetem ne keto raste:

- a) për çdo shkak të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaf-tueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- d) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- dh) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara ligj;
- e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

Neni 26

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi te njoftoje me shkrim për arsyet e largimit shoqërinë.


Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Ne këto raste zbatohen parashikimet e neneve 102, 103 dhe 104 te Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 27

LIKUIDIMI

Kur me vendim gjykate shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe ne rastet e parashikuara ne statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme te shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit qe do te kryhen sipas kërkesave te parashikuara ne Ligjin "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ne përgjithësi nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.



ORTAKËT E SHOQERISE "KORÇA IMPORT-EXPORT" SHPK

PA DERUO GIANFRANCO

Pepo Gj

DOL BLANCO OLIVERO

W Del Bieri

Denis Lika

D-Lika